



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Vetëm

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 27 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi kërkesën për dorëzani**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit kujdestar të**  
**Nasim Haradinajt**  
Bastian Martens

**GJYKATËSI I VETËM**,<sup>1</sup> në bazë të nenit 41 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 57(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) kërkoi arrestimin e Hysni Gucatit (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) për shpërndarjen e pretenduar të informacionit konfidencial lidhur me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) gjatë tri konferencave për shtyp dhe transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”).<sup>2</sup>

2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet për z. Gucati dhe z. Haradinaj për tentim të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe urdhëroi transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të DHS-së (“Vendimi për arrestim dhe transferim”).<sup>3</sup>

3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati u arrestua<sup>4</sup> dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm sipas nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik, f. 5.

<sup>2</sup> Kërkesë e ZPS-së për lëshimin e fletarrestimit, para. 1, 35(a).

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi kërkesën për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave të transferimit*, (“Vendimi për arrestim dhe transferim”), 24 shtator 2020, publik, para. 36, me shtojcat 1-4, publike të redaktuara.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i fletarrestimit për Hysni Gucatin* (“Fletarrestimi”), 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i redaktuar publik i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i pranimit të Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

4. Më 29 shtator 2020, z. Gucati dorëzoi “Kërkesën për dorëzani (“Kërkesa”).<sup>6</sup> ZPS-ja dorëzoi përgjigje në lidhje me këtë kërkesë më 9 tetor 2020.<sup>7</sup> Z. Gucati nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

5. Më 1 tetor 2020, z. Gucati bëri paraqitjen e parë para gjykatësit.<sup>8</sup>

## II. PARASHTRIME

6. Z. Gucati parashtron se mbajtja e mëtejshme e tij në paraburgim është e papërligjur për sa kohë që rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit<sup>9</sup> mund të trajtohen me masa alternative. Ai propozon këto masa alternative: dorëzanimë në shumën prej 5000 eurosh, dorëzimin e pasaportës, qëndrimin dhe fjetjen në shtëpi, paraqitjen e përditshme në zyrat e policisë së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (“EULEX”), kufizimin e kontakteve dhe ndalimin e vizitave në zyrat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL UÇK”) (bashkërisht të quajtura “kushtet e propozuara”).<sup>10</sup> Gjithashtu, z. Gucati parashtron se në këto rrethana paraburgimi i tij është masë shproporcionale duke pasur parasysh që: (i) ai ishte bashkëpunues gjatë arrestimit; (ii) nuk akuzohet për ndonjë veprë penale; (iii) veprat penale nën hetim nuk përfshijnë përdorim të forcës, kërcënime apo dëme konkrete; dhe dënimet maksimale për veprat penale përkatëse janë relativisht të ulëta.<sup>11</sup> Së fundi, z. Gucati pretendon se lidhjet e tij të forta familjare dhe me komunitetin si dhe problemet shëndetësore krijojnë rrethanat në të cilat mund të miratohet dorëzania sipas kushteve të propozuara.<sup>12</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00038, Mbrojtja, *Kërkesë për dorëzani*, 29 shtator 2020, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, F00045, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirimin*, 9 tetor 2020 (“Përgjigjja”), publike.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik.

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 4; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 17, rreshti 25 deri f. 18, rreshti 4.

<sup>10</sup> Kërkesa, para. 5-6; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 17, rreshti 4 deri f. 19, rreshti 25.

<sup>11</sup> Kërkesa, para. 6; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 20, rreshti 3 deri f. 21, rreshti 7.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 18, rreshti 5 deri f. 19, rreshti 8.

7. ZPS-ja parashtron se kriteret e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit për vazhdimin e mbajtjes në paraburgim janë përmbushur<sup>13</sup> dhe se parashtrimet e Mbrojtjes shpërfillin rrethanat që çuan në arrestimin e z. Gucati.<sup>14</sup> ZPS-ja pretendon se njoftimi i lëshimit të fletarrestimit kundër z. Gucati ka rritur motivet e tij për t'u arratisur, për të penguar procesin dhe për të kryer krime të tjera.<sup>15</sup> Gjithashtu, ZPS-ja pretendon se kushtet e propozuara nga z. Gucati për lirimin e tij me kusht nuk mjaftojnë për të eliminuar rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b).<sup>16</sup> Në lidhje me problemet shëndetësore të z. Gucati, ZPS-ja argumenton se çështje të tilla nuk kanë lidhje me rreziqet që parashikohen në nenin 41(6)(b) dhe nuk përbëjnë arsye bindëse për të përligjur lirimin e tij për arsye humanitare.<sup>17</sup> ZPS-ja parashtron se kërkesa duhet të refuzohet.<sup>18</sup>

### III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Neni 41(6) i Ligjit përcakton se DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur ekziston dyshimi i bazuar se ai ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së; dhe ekzistojnë arsye të artikuleshme të besohet se (i) ekziston rreziku i arratisjes; (ii) personi do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova ose kur rrethana të caktuara tregojnë se personi do të pengojë ecurinë e procedimit penal; ose (iii) do të përsërisë ose do të tentojë të përsërisë veprat penale.

9. Neni 41(12) i Ligjit përcakton se krahas mbajtjes në paraburgim, mund të urdhërohen edhe masat në vijim për të siguruar praninë e të akuzuarit, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale apo për të siguruar zhvillimin me sukses të procedimit penal: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve ose personave të

---

<sup>13</sup> Përgjigja, para. 4.

<sup>14</sup> Përgjigja, para. 5, 7-8. KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 22, rreshtat 1-17.

<sup>15</sup> Përgjigja, para. 9; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 21, rreshtat 21-25.

<sup>16</sup> Përgjigja, para. 10-11; KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 22, rreshtat 18-22.

<sup>17</sup> Përgjigja, para. 12.

<sup>18</sup> Përgjigja, para. 13.

caktuar, paraqitja në një stacion policie apo vend tjetër, dhe masa alternative shmangëse.

10. Rregulla 56(3) e Rregullores parasheh që paneli mund të urdhërojë lirimin e përkohshëm të paraburgosurit, kur ky lirim përlligjet prej arsyeve humanitare bindëse.

11. Sipas rregullës 57(1) të Rregullores, rivlerësimin e mbajtjes në paraburgim të një të dyshuari e bën Gjykatësi i Vetëm, me kërkesë të dyshuarit, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave. Paraburgimi sipas kësaj dispozite nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) vit.

#### IV. DISKUTIM

##### A. VLERËSIMI I KUSHTEVE TË PROPOZUARA

12. Gjykatësi i Vetëm vëren se z. Gucati nuk pranon ekzistencën e dyshimit të bazuar,<sup>19</sup> por nuk parashtron asnjë argument lidhur me arsyet pse nuk është përmbushur standardi i përcaktuar në nenin 41(6)(a) të Ligjit. Gjithashtu, ai nuk kundërshton vlerësimin e tij të mëhershëm mbi rreziqet sipas nenit 41(6)(b), por përkundrazi pohon se kushtet e propozuara për lirimin e tij i trajtojnë këto rreziqe.<sup>20</sup> Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm do të vlerësojë nëse kushtet e propozuara janë të mjaftueshme për të trajtuar rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit.

13. Z. Gucati parashtron se kushtet e propozuara trajtojnë në mënyrën e duhur çdo rrezik të arratisjes.<sup>21</sup> ZPS-ja përgjigjet se kushtet e propozuara nuk arrijnë t'i trajtojnë këto rreziqe si duhet,<sup>22</sup> duke vënë veçanërisht në dukje se (i) propozimi i

---

<sup>19</sup> KSC-BC-2020-07, F00033, Mbrojtja, *Kundërshtim i ligjshmërisë së arrestimit në pajtim me nenin 41(2): Kërkesë për dhënie të informacionit*, 30 shtator 2020, publik, para. 4(a)-(c).

<sup>20</sup> Kërkesa, para. 6.

<sup>21</sup> Kërkesa, para. 5-6.

<sup>22</sup> Përgjigja, para. 10.

z. Gucati për dorëzimin e pasaportës së tij nuk merr parasysh faktin se nga Kosova mund të kryhen udhëtime ndërkombëtare pa pasaportë në vende të tilla si Shqipëria dhe (ii) garancia monetare e propozuar është e pamjaftueshme duke pasur parasysh qasjen që z. Gucati ka në burimet financiare të OVL-UÇK-së.<sup>23</sup>

## 1. Rreziku i arratisjes

14. Për sa i takon rrezikut të arratisjes, Gjykatësi i Vetëm gjykon se, krahas faktorëve të përmendur në vendimin për arrestim dhe transferim,<sup>24</sup> njoftimi mbi lëshimin e fletarrestimit dhe angazhimi i ZPS-së për të dorëzuar Aktakuzën brenda një muaji<sup>25</sup> shtojnë motivimin e z. Gucati për t'u arratisur. Sidoqoftë, Gjykatësi i Vetëm është i vetëdijshëm për faktin se kushtet e propozuara mund t'i zvogëlojnë këto lloj rreziqesh. Në këtë drejtim, Gjykatësi i Vetëm vlerëson në mënyrë të favorshme garancinë monetare në shumën prej 5000 eurosh, dorëzimin e pasaportës së z. Gucati, premtimin se ai do të flejë çdo natë në shtëpinë e tij dhe paraqitjen e përditshme në zyrat e policisë së EULEX-it. Lidhjet e forta familjare dhe me komunitetin të z. Gucati gjithashtu zvogëlojnë rrezikun që ai të arratiset.<sup>26</sup>

15. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kushtet e propozuara trajtojnë në mënyrën e duhur rrezikun që z. Gucati mund të arratiset. Megjithatë, duhet të vlerësohet nëse kushtet e propozuara trajtojnë në mënyrën e duhur rreziqet e tjera.

## 2. Pengimi i ecurisë së procesit penal

16. Sa i përket rrezikut që z. Gucati të pengojë procesin penal duke shpërndarë informacionin konfidencial dhe jopublik, Gjykatësi i Vetëm rikujton se z. Gucati ka marrë pjesë në shpërndarjen e paautorizuar të informacionit konfidencial dhe

---

<sup>23</sup> Përgjigjja, para. 11.

<sup>24</sup> Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 28.

<sup>25</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 15, rreshtat 19-22.

<sup>26</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 18, rreshtat 5-12, 20-22.

jopublik.<sup>27</sup> Shpërndarja e informacionit konfidencial dhe jopublik vazhdoi edhe pasi z. Gucati u urdhërua në dy raste të mos e bënte këtë.<sup>28</sup> Në fakt, pas lëshimit të këtyre urdhrave, z. Gucati deklaroi publikisht se ai dhe OVL-UÇK-ja do të vazhdonin të publikonin të gjitha dokumentet që do të merrnin<sup>29</sup> dhe nxiti përfaqësuesit e mediave të bënin të njëjtën gjë.<sup>30</sup>

17. Asnjë nga kushtet e propozuara nuk garanton në mënyrën e duhur që z. Gucati nuk do të pengojë ecurinë e procesit. Nëse lirohet, z. Gucati do të ishte në gjendje të merrte, pa mbikëqyrje, informacion konfidencial dhe jopublik. Ai do të kishte gjithashtu mjete për shpërndarjen e atij informacioni duke komunikuar lirisht me mediat ose me rrjetin e tij të veteranëve të UÇK-së, ose duke e publikuar vetë materialin. Asnjë zotim personal për të mos kryer veprime të tilla nuk mund të besohet, duke pasur parasysh deklaratat publike të tij me të cilat betohet se do të vazhdojë të nxjerrë informacione konfidenciale dhe jopublike<sup>31</sup> dhe refuzimin e tij për t'iu bindur urdhrave të Gjykatësit të Vetëm.<sup>32</sup>

18. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Vetëm konstaton se kushtet e propozuara nuk trajtojnë në mënyrën e duhur rrezikun që z. Gucati mund të pengojë ecurinë e procesit.

### 3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

19. Për sa i takon rrezikut që z. Gucati mund të kryejë vepra penale të tjera, për arsyet e diskutuara më lart lidhur me pengimin e procesit, Gjykatësi i Vetëm konstaton se ende ekziston rreziku që z. Gucati mund të kryejë vepra penale të

<sup>27</sup> Vendimi për arrestim dhe transferim, para. 29.

<sup>28</sup> KSC-BC-2020-07, F00005, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim urgjent që autorizon sekuestrim ("Urdhri i parë")*, 7 shtator 2020, publik, para. 22; KSC-BC-2020-07, F00007, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim që autorizon sekuestrim ("Urdhri i dytë")*, 17 shtator 2020, publik, para. 22.

<sup>29</sup> Shtojca 1 e kërkesës së ZPS-së për lëshimin e fletarrestimit, f. 13.

<sup>30</sup> Shtojca 1 e kërkesës së ZPS-së për lëshimin e fletarrestimit, f. 23.

<sup>31</sup> Shtojca 1 e kërkesës së ZPS-së për lëshimin e fletarrestimit, f. 13.

<sup>32</sup> Urdhri i parë, para. 22; Urdhri i dytë, para. 22.

tjera duke kërcënuar, frikësuar ose rrezikuar dëshmitarë (të mundshëm) përmes nxjerrjes ose shpërndarjes së informacionit konfidencial dhe jopublik dhe se asnjë nga kushtet e propozuara nuk është i mjaftueshëm për të zvogëluar këto rreziqe.

20. Rrjedhimisht, Gjykatësi i vetëm konstaton se kushtet e propozuara nuk trajtojnë në mënyrën e duhur rrezikun që z. Gucati mund të kryejë vepra penale të tjera.

#### 4. Përfundim

21. Gjykatësi i Vetëm arrin në përfundimin se vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm pasi kushtet e propozuara nuk eliminojnë të gjitha rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b).

#### B. PROBLEMET SHËNDETËSORE DHE FAKTORË TË TJERË

22. Z. Gucati parashtron se mbajtja e mëtejshme e tij në paraburgim është masë shproporcionale duke marrë parasysh problemet shëndetësore të z. Gucati,<sup>33</sup> faktin që ai ishte bashkëpunues gjatë arrestimit, mungesën e akuzave të konfirmuara dhe llojin e veprave penale të pretenduara e dënimet e mundshme për to.<sup>34</sup> ZPS-ja përgjigjet se problemet shëndetësore të z. Gucati duket se nuk kanë lidhje me rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) dhe nuk përlligjin lirin e tij për arsye humanitare,<sup>35</sup> ndërsa faktorët e tjerë nuk arrijnë të garantojnë në mënyrën e duhur që z. Gucati nuk do të arratiset, nuk do të pengojë procesin ose nuk do të kryejë vepra penale të tjera.<sup>36</sup>

---

<sup>33</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 18, rreshtat 13-19.

<sup>34</sup> Kërkesa, para. 6.

<sup>35</sup> Përgjigja, para. 12.

<sup>36</sup> Përgjigja, para. 10.



23. Për sa u përket problemeve shëndetësore të z. Gucati që u shtruan gjatë paraqitjes së tij të parë dhe në lidhje me kërkesën,<sup>37</sup> Gjykatësi i Vetëm gjykon se në dukje dhe pa dhënë hollësi të tjera, këto probleme shëndetësore vijnë nga sëmundje të zakonshme, të trajtueshme, të cilat nuk e ndryshojnë vlerësimin e tij lidhur me rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b) dhe nuk përbëjnë arsye humanitare bindëse që përlligjin lirimin e përkohshëm të një të paraburgosuri sipas rregullës 56(3) të Rregullores.

24. Së fundi, në lidhje me faktin që z. Gucati ishte bashkëpunues gjatë arrestimit të tij, mungesën e Aktakuzës, llojin jo të dhunshëm të veprave penale që hetohen, mungesën e pretendimeve për kërcënime apo dëme konkrete dhe dënimet e mundshme minimale për veprat penale përkatëse,<sup>38</sup> Gjykatësi i Vetëm gjykon se, siç u theksua më lart, shqetësimi kryesor që bën të domosdoshëm arrestimin dhe paraburgimin e tij, është rreziku që z. Gucati të pengojë procesin ose të kryejë vepra penale të tjera. Këta faktorë të tjerë nuk e cenojnë këtë vlerësim dhe, në këto rrethana, nuk e bëjnë mbajtjen e tij të mëtejshme në paraburgim të paarsyeshme ose shproporcionale.

## V. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

**REFUZON** kërkesën.

/nënshkrimi/

**Gjykatësi Nikola Giju**  
**Gjykatës i Vetëm**

E martë, 27 tetor 2020

Në Hagë, Holandë

<sup>37</sup> KSC-BC-2020-07, Transkripti, 1 tetor 2020, publik, f. 18, rreshtat 13-19.

<sup>38</sup> Kërkesa, para. 6.